

BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT



PLANI STRATEGJIK 2022-2024

“Bankë qendrore e cila me vendime fleksibile, të menduara siç duhet dhe në kohë, në periudhë ndryshimesh të shpejta dhe transformimit digjital, kontribuon për standard më të lartë jetese të qytetarëve duke krijuar mjedis të zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës”.

qershor 2021

Përmbajtja

Fjala e guvernatorit	2
I. Dispozitat e Përgjithshme	4
II. Mandati dhe Kompetencat	4
III. Mësimet dhe përvojat e fituara nga zbatimi i Planit Strategjik 2020 - 2022.....	5
IV. Analizë e mjedisit	6
1. Mjedisi i jashtëm	6
2. Gjendja e brendshme e Bankës Popullore.....	7
V. Qëllimet strategjike të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut	7
Kapaciteti institucional	8
Qëllimi strategjik 1- Përmirësimi i infrastrukturës për zhvillimin e politikës monetare	9
Qëllimi strategjik 2 - Ruajtja dhe forcimi i mëtejshëm i stabilitetit dhe rezistencës të sistemit bankar	10
Qëllimi strategjik 3 - Mbështetja e popullatës dhe sektorit të korporatave përmes zhvillimit të sistemeve pagesore të besueshme, inovative dhe efikase	11
Qëllimi strategjik 4 - Përmirësimi i politikës së investimeve dhe sigurimi i kthimit optimal të rezervave valutore në pajtim me parimet e sigurisë dhe likuiditetit	12
Qëllimi strategjik 5 - Përshtatja me standardet e Sistemit European të bankave qendrore ...	13
Qëllimi strategjik 6 - Rritja e transparencës dhe llogaridhënies	14
Qëllimi strategjik 7 – Edukimi financiar dhe gjithëpërfshirja	15
Qëllimi strategjik 8 – Rritja e ndërgjegjësimit për ndryshimet klimatike dhe kontributi për ekonomi të gjelbër e të qëndrueshme.....	16
Qëllimi strategjik 9 - Forcimi i menaxhimit të riskut në nivel të Bankës Popullore	17
VI. Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare	18

Fjala e guvernatorit

Në çdo tre vjet, Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë Veriore miraton Planin Strategjik, i cili është kornizë afatmesme sipas së cilës i zhvillojmë aktivitetet tona. Definimi i Planit Strategjik është mundësi për të parë prapa dhe për të parë se çfarë është arritur, duke u fokusuar në të njëjtën kohë në sfidat dhe mundësitë e reja që janë përpara.

Për të kuptuar sfidat, bëmë analizë të mjedisit, vlerësim të gjendjes aktuale në Bankën Popullore dhe duke marrë parasysh mësimet e nxjerra nga e kaluara, krijuam Planin Strategjik i cili është çelësi për arritjen e vizionit tonë. Ideja e inovacionit dhe ndjekja për të qenë bankë moderne dhe fleksibile në hap me ndryshimet e shpejta të teknologjisë dhe digjitalizimit janë postulatet kryesore të këtij plani strategjik.

Motoja e këtij plani strategjik është: "bankë qendrore e cila përmes vendimeve fleksibile, të dizajnuara në mënyrë të duhur dhe në kohë, në periudhë ndryshimesh të shpejta dhe transformimi digjital, kontribuon në standard më të lartë jetese të qytetarëve duke krijuar mjedis të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës të zhvillimit ekonomik ". Nëpërmjet tij realizojmë vizionin tonë, që është njohja si *institucion i pavarur, i përgjegjshëm, profesional, inovativ dhe transparent, i cili gëzon besim dhe kredibilitet të lartë tek publiku.*

Përmes qëllimeve strategjike fokusohemi në fushat më të rëndësishme të operimit të Bankës Popullore. Këtë vit, bëmë ripërcaktim, duke iu përshtatur mjedisit dinamik dhe sfidave të reja. Në plan përfshihen qëllimet tradicionale të cilat lidhen me zbatimin e politikës monetare, stabilitetin e sistemit bankar, funksionimin normal të sistemeve pagesore, menaxhimin e rezervave valutore, por i vëndohet theks i veçantë sfidave dhe tendencave të reja të cilat do të jenë të pranishme në këto fusha në tre vitet e ardhshme.



**Guvernatore dhe Kryesuese e Këshillit të
Bankës Popullore të Republikës së
Maqedonisë së Veriut
dr. Anita Angellovska-Bezhoska**

Njëkohësisht, në periudhën e kaluar, duke ndjekur ndryshimet dinamike të mjedisit, në mënyrë vizionare kemi identifikuar segmentet të cilave duhet t'u kushtohet vëmendje e veçantë dhe në të cilat si bankë qendrore duhet të investojmë burime dhe energji shtesë. E gjithë kjo është me qëllim që në mënyrë proaktive të kontribuojë në rritjen e qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse të ekonomisë maqedonase, njëkohësisht duke ofruar mbështetje gjatë kalimit në ekonomi digjitale. Rrjedhimisht, fokusi është vënë në edukimin financiar dhe gjithëpërfshirjen duke pasur parasysh rëndësinë e rritjes së ndërgjegjësimit për përfitimet e përdorimit të shërbimeve të ndryshme financiare në kohë të inovacionit teknologjik, si dhe rritjen e ndërgjegjësimit për rrezikun, i cili do të siguronte përfundimisht përfshirje më të madhe të popullsisë dhe ndërmarrjeve të vogla në flukset financiare dhe lehtësim të qasjes në financa. Në të njëjtën kohë, zhvillojmë ndërgjegjësimin ndaj ndryshimeve klimatike, si një nga kërcënimet më të mëdha globale dhe si institucion përgjegjës shoqëror, qëllimi ynë i veçantë strategjik është të kontribuojmë në krijimin e ekonomisë "të gjelbër" dhe të qëndrueshme, e cila përfundimisht do të përmirësonte cilësinë e jetës së qytetarëve dhe përmirësimin e standardit të tyre jetësor.

Në fund, dëshiroj të theksoj se përgatitja e planit strategjik është proces kreativ dhe gjithëpërfshirës, në të cilin të gjithë së bashku përcaktojmë qëllimet strategjike, të cilat janë pasqyrim i misionit, vizionit dhe vlerave tona dhe të cilat do të mundësojnë përmbushjen e suksesshme të mandatit dhe kompetencave tona. Gjatë gjithë këtij procesi, si deri më tani, do të mbështetemi në vlerat tona thelbësore - cilësinë, integritetin, besnikërinë, transparencën, udhëheqjen, inovacionin, fleksibilitetin, profesionalizmin dhe shpirtin ekipor.

Në bazë të nenit 47, paragrafi (1), pika 9) nga Ligji i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15 dhe 6/16) dhe neni 12 paragrafi (3) nga Rregullorja e Planifikimit Strategjik dhe Operativ, Rr. nr. 02-15/I-1/2016 nga 28 Janar 2016, dhe Rr. nr. 02-15 / VI-1/2020 nga data 28 Prill 2020 Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë miratoi

Plani Strategjik i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë për periudhën 2022 - 2024

I. Dispozitat e Përgjithshme

1. Plani Strategjik i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtejshëm: Banka Popullore) përcaktohet në bazë të **misjonit, vizionit dhe vlerave organizative** të Bankës Popullore, në varësi nga mjedisi makroekonomike dhe sfidat kryesore dhe përmban **qëllimet themelore strategjike** për periudhën e ardhshme tre vjeçare.

Plani Strategjik rishikohet çdo vit dhe paraqet bazë për përgatitjen e programit për punë, me të cilën përcaktohen programet vjetore për realizimin e qëllimeve strategjike.

MISIONI

Duke përmbushur mandatin dhe kompetencat e saj, ajo kontribuon në ruajtjen e stabilitetit të çmimeve dhe financiare për zhvillim të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës ekonomik dhe standarde më të larta jetese të qytetarëve. Kontribuon në ruajtjen e sistemit financiar të qëndrueshëm, konkurrues dhe të orientuar drejt tregut, rezistent dhe fleksibël ndaj ndryshimeve të shpejta të mjedisit, i cili funksionon në interesin më të mirë të konsumatorëve dhe të ekonomisë në përgjithësi.

VIZIONI

Vizioni i Bankës Popullore është që ajo të njihet si një institucion i pavarur, i përgjegjshëm, profesional dhe transparent dhe që gëzon besim të lartë dhe kredibilitet në opinion.

VLERAT

Banka Popullore funksionon në pajtueshmëri me parimet dhe vlerat në vijim: cilësi, integritet, besnikëri, transparencë, leadership, inovacion, fleksibilitet, profesionalizëm dhe shpirtin ekipor.

II. Mandati dhe Kompetencat

1. Qëllimi **kryesor ligjor** i Bankës Popullore është arritja dhe ruajtja e stabilitetit të çmimeve. Qëllim tjetër, krahas qëllimit kryesor është që ajo të kontribuojë në ruajtjen e sistemit stabil financiar, konkurrues dhe të orientuar kah tregu, ndërsa qëllim i tretë është përkrahja e Bankës Popullore në politikën e përgjithshme ekonomike pa e rrezikuar realizimin e qëllimit kryesor dhe në pajtueshmëri me parimin e një ekonomie tregu të hapur me konkurrencë të lirë.

2. Banka Popullore është e detyruar ndaj më shumë **detyrimeve** ligjore, ndërkaq veçojmë disa prej tyre:



III. Mësimet dhe përvojat e fituara nga zbatimi i Planit Strategjik 2020 - 2022

Përvojat nga zbatimi i deritanishëm i Planit Strategjik për periudhën 2020 - 2022 kanë treguar se Banka Popullore edhe në kohë sfidash të forta globale, siç është pandemia globale shëndetësore, me sukses ka arritur qëllimet dhe detyrat ligjore të cilat janë kontribut i rëndësishëm për arritjen e stabilitetit të përgjithshëm makroekonomik. Njëkohësisht, me marrjen e masave dhe vendimeve të duhura dhe me kohë në sferën monetare dhe financiare, Banka Popullore i dha mbështetje ekonomisë së Maqedonisë në ballafaqimin me pasojat ekonomike të pandemisë. Në këtë kontekst, për të zbutur efektet potenciale në ekonomi të shkaktuara nga kriza shëndetësore, Banka Popullore ka miratuar disa vendime dhe masa në pajtim me kompetencat e saj për ruajtjen e stabilitetit monetar dhe financiar, si dhe për përmirësimin e mjedisit të përgjithshëm të punës së kompanitë dhe mbështetjen e ekonomisë maqedonase.

Realizimi i qëllimeve të parapara strategjike, në pajtim me Raportin e Realizimit të Aktiviteteve Programore për vitin 2020, tregoi se potenciali më i madh i Bankës Popullore janë punëtorët. Pjesa më e madhe e aktiviteteve janë realizuar, pavarësisht pandemisë së Kovid-19, gjë që konfirmon kapacitetin institucional, profesionalizmin, ekspertizën, përkushtimin dhe gatishmërinë e punonjësve, si dhe aftësitë e ekipit drejtues. Investimi i përhershëm në vazhdimin e edukimit të punonjësve të Bankës Popullore jo vetëm që inkurajon inovacionin dhe kreativitetin e tyre, por mundëson realizimin më efikas të qëllimeve aktuale strategjike dhe ndjekjen e trendeve botërore në fushën e sferës monetare dhe financiare dhe sistemeve pagesore, si dhe përfshirja në kohë e tyre në objektivat strategjike për tre vitet e ardhshme.

Krahas kapacitetit të punonjësve, rëndësi të madhe ka edhe qasja holistike dhe e adaptueshme në operimin e Bankës Popullore. Domethënë, nga episodet e krizës kemi nxjerrë mësim se çdo krizë e re është e ndryshme nga ajo e mëparshme. Politika monetare bazohet gjithnjë e më shumë në instrumente monetare jokonvencionale, ndërkohë që sistemi financiar

po ndryshon vazhdimisht dhe po bëhet gjithnjë e më i ndërlikuar. Tendencat tilla tregojnë se drejtimi i politikës monetare duhet të jetë fleksibël, në pajtim me politikën makroprudenciale dhe përdorimi i instrumenteve jo konvencionale duhet të bazohet në qasje inovative dhe të synuar, të përshtatur me rrethanat specifike. Njëkohësisht, rëndësi të veçantë ka edhe komunikimi i bankës qendrore me publikun, si mënyrë për të vepruar ndaj pritshmërive dhe sjelljes së subjekteve ekonomike, e cila është e rëndësishme për transmetimin efikas të sinjaleve monetare.

IV. Analizë e mjedisit

1. Mjedi i jashtëm

Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut, që nga fillimi i ekzistencës së saj e deri më tani, përmes hartimit të duhur dhe zbatimit në kohë të politikës monetare dhe financiare është shtytës aktiv i proceseve në ekonominë maqedonase në rrugën drejt arritjes së rritjes ekonomike dhe mbështetjes së zhvillimit. Këtë e arrin duke investuar vazhdimisht në kapacitetin e punonjësve të saj dhe duke ndjekur standardet më të fundit e më të larta, si dhe praktikën më të mira në operimin e bankës qendrore.

Në kohë të ndryshimeve të shpejta në skenën globale, si rezultat i proceseve të globalizimit, digjitalizimit, inovacionit dhe pandemisë globale të shëndetit, roli, funksionet dhe aktivitetet e bankës qendrore po evoluojnë vazhdimisht. Në këtë kuptim, Banka Popullore duhet të përshtatet dhe në arritjen e qëllimeve të saj duhet të ketë parasysh ndryshimet në shoqëri, ekonominë vendase dhe tendencat në ekonominë globale. Aktualisht, ndryshimet në mjedisin e jashtëm dhe të brendshëm po ndodhin më shpejt se më parë, gjë që imponon nevojën për njohjen në kohë të tyre dhe përshtatjen e duhur të operimit.

Proceset të cilat përcaktojnë dhe ndikojnë në masë të madhe rolin "e ri" të një banke qendrore moderne janë:

Globalizimi. Ekonomia globale gjithnjë e më e integruar është proces i drejtuar nga përparimet tekniko-teknologjike dhe inovacionet e përditshme, nga njëra anë, dhe liberalizimi në rritje i tregjeve dhe tregjeve të kapitalit, nga ana tjetër.

Përparimi teknologjik dhe inovacioni. Periudha e kaluar karakterizohet nga fluks ndryshimesh dhe inovacionesh teknologjike, si interneti, tregtia elektronike, telefonat celularë, inteligjenca artificiale dhe sasi të mëdha të të dhënave (angl.: Big Data), të cilat me shpejtësi po riformësojnë ekonominë globale. Në sektorin financiar, kompanitë e reja të fintekut po konkurrojnë me modelet tradicionale të biznesit bankar dhe ofrojnë shërbime më komplekse duke filluar nga sistemet pagesore, deri te kursimet, huadhënia, menaxhimi i rrezikut dhe këshillat financiare.

Industria e fintekut gradualisht e pushton sektorin financiar. Teknologjia e informacionit mund të ketë ndikime të rëndësishme, në drejtim të rritjes së konkurrencës dhe ripërcaktimit të marrëdhënieve midis konsumatorëve dhe ofruesve të shërbimeve financiare, rritjes së efikasitetit, përfshirjes më të mirë financiare dhe përmirësimin e cilësisë duke ofruar shërbime të përshtatura për nevojat e konsumatorëve.

Tregtia elektronike në Republikën e Maqedonisë së Veriut është në rritje gjatë viteve të fundit, gjë që është bërë e mundur nga depërtimi i shpejtë i internetit dhe përparimi i digjitalizimit. Tregtia elektronike ofron qasje dhe mënyrë të re të kryerjes së transaksioneve tregtare dhe ka potencialin të bëhet shtytës global i rritjes dhe zhvillimit ekonomik. Për të përfituar plotësisht nga përfitimet e tregtisë elektronike, është e nevojshme ofertë më e madhe e zgjidhjeve inovative pagesore nga ofruesit ekzistues dhe të rinj të shërbimeve pagesore të cilat do të mundësojnë pagesa të shpejta, efikase dhe të sigurt për blerjet përmes internetit. Ndërkaq, korniza rregullatore e re në fushën e pagesave do të jepte kontribut të rëndësishëm në pasurimin e mënyrave të inicimit të pagesave për transaksionet tregtare të kryera përmes internetit.

Goditjet e jashtme (krizat ekonomike, pandemitë, ndryshimet klimatike). Arritja e qëllimeve dhe objektivave në kushte dinamike dhe të pasigurta të mjedisit të jashtëm dhe të brendshëm, veçanërisht në periudhën e rimëkëmbjes ekonomike nga pandemia Covid-19, imponon nevojën për monitorim të rregullt të lëvizjeve, modernizim të vazhdueshëm të mjeteve dhe qasjeve për vlerësimin e rrezikut, forcimi i kapacitetit të projektimit dhe fleksibilitet të mtejshëm të politikave.

2. Gjendja e brendshme e Bankës Popullore

Analiza e mjedisit të brendshëm tregon nevojën për ndryshime në mënyrën se si Banka Popullore i kryen detyrat e saj, të kushtëzuara nga ndryshimet e shpejta teknologjike dhe nga mësimet dhe përvoja e deritanishme. Këto ndryshime dhe sfida kanë të bëjnë me:

- ❖ Nevojën për shkallë të lartë ndërveprimi ndërmjet punonjësve dhe ekipeve ndërdisiplinore;
- ❖ Automatizim më të madh të procedurave për shkak të ndryshimeve në teknologji.
- ❖ Rritjen e njohurive dhe aftësive;
- ❖ Nevoja për të tërhequr vëmendjen e specialistëve si rezultat i tendencave të reja në sektorin bankar, respektivisht në sektorin financiar;
- ❖ Tërheqja dhe mbajtja e specialistëve të teknologjisë informatike.

V. Qëllimet strategjike të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Plani strategjik i Bankës Popullore për periudhën 2022 - 2024 është nën moton *bankë qendrore e cila me vendime fleksibile, të menduara siç duhet dhe në kohë, në periudhë ndryshimesh të shpejta dhe transformimit digjital, kontribuon për standard më të lartë jetese të qytetarëve duke krijuar mjedis të zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës*. Në këtë kuptim, qëllimi i Planit të ri Strategjik të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut është të forcojë më tej bazat e sistemit monetar, financiar dhe të pagesor, i cili do të ndihmojë në krijimin e kushteve të qëndrueshme për rritje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse të ekonomisë maqedonase, dhe në të njëjtën kohë do të mundësojnë edhe mbështetje në tranzicionit në ekonomi digjitale në kushtet e mjedisit të pasigurt dhe të ndërlikuar.

Banka Popullore ka prirje në përmbushjen cilësore dhe efikase të misionit të saj dhe kujdeset që vazhdimisht të rrisë reputacionin e saj, duke forcuar kështu besimin e qytetarëve dhe palëve të tjera të interesit (angl.: stakeholders). Në këtë kontekst, vazhdimisht përpiqet të përmirësojë cilësinë e procesit të planifikimit strategjik, duke pasur parasysh rolin e saj të rëndësishëm në realizimin e suksesshëm të misionit dhe vizionit të Bankës Popullore. Plani

Strategjik i periudhës 2022-2024 është përgjigje e shumë sfidave kryesore të cilat dalin nga analiza e mjedisit.

Realizimi i vizionit dhe misionit të tij brenda mandatit dhe kompetencave të tij në tre vitet e ardhshme do të drejtohet përmes **qëllimeve strategjike** të mëposhtme:

QS1	Përmirësimi i infrastrukturës për zhvillimin e politikës monetare
QS2	Ruajtja dhe forcimi i mëtejshëm i stabilitetit dhe rezistencës së sistemit bankar
QS3	Mbështetja e popullatës dhe sektorit të korporatave duke zhvilluar sisteme pagesore të besueshme, inovative dhe efikase
QS4	Përmirësimi i politikës së investimeve dhe sigurimi i kthimit optimal të rezervave valutore në pajtueshmëri me parimet e sigurisë dhe likuiditetit
QS5	Përshtatja me standardet e Sistemit Europian të Bankave Qendrore
QS6	Rritja e transparencës dhe llogaridhënies
QS7	Edukimi financiar dhe gjithëpërfshirja
QS8	Rritja e ndërgjegjësimit për ndryshimet klimatike dhe kontributit për ekonomi të gjelbërt të qëndrueshme
QS9	Forcimi i menaxhimit të rrezeve në nivel të Bankës Popullore

Kapaciteti institucional

Banka Popullore do të vazhdojë të bazojë realizimin e qëllimeve strategjike në kapacitetet e saj institucionale të cilat janë kryesore në realizimin e qëllimeve strategjike, dhe atë:

Integritet dhe besueshmëri në monedhën kombëtare	Banka Popullore si bankë emetuese e vetme do të vazhdojë të ruajë integritetin dhe besueshmërinë në monedhën kombëtare përmes funksionimit efikas të sistemit të furnizimit me para të gatshme dhe garantimit të cilësisë standarde të kartëmonedhave dhe monedhave të farkëtuara në qarkullim.
Burimet njerëzore	Zhvillimi i mëtejshëm i potencialit modern dhe kompetent njerëzor , fleksibël ndaj ndryshimeve të shpejta në mjedis. Përpunim i strategjisë së menaxhimit të burimeve njerëzore për t'u siguruar numër optimal të punonjësve në aspektin cilësor dhe sasior, të cilët do të mundësojnë arritjen e qëllimeve strategjike, si dhe përshtatjen me nevojat e Bankës Popullore.
Sistemi informatik	Ruajtja e sistemit të qëndrueshëm të informacionit dhe përmirësimi i vazhdueshëm i tij në kushtet e ndryshimit intensiv të vazhdueshëm të teknologjisë së informacionit. Prezantimi i transformimit digjital për të thjeshtuar proceset e brendshme dhe për të rritur efikasitetin dhe produktivitetin.
Të dhënat statistikore	Sigurimi i statistikave cilësore, në kohë dhe lehtësisht të qasshme. Zhvendosja e mëtejshme e të dhënave drejt platformave statistikore më të zhvilluara, nëpërmjet ndërtimit të skedari të vetëm i të dhënave statistikore dhe aplikimit të mjeteve moderne dhe efikase në përgatitjen e të dhënave statistikore. Përmirësimi i procesit të menaxhimit të të dhënave statistikore, i cili duhet të mundësojë pajtueshmëri më të madhe të të dhënave statistikore dhe efikasitet të procesit të përgatitjes së tyre. Për këtë qëllim është edhe vendosja e sistemit të integruar raportues në pajtim me nevojat e sistemit informativ të Bankës Popullore për përbushjen e qëllimeve dhe detyrave të saj.
	Zhvillimi i veprimtarisë hulumtuese në fushat të cilat janë me rëndësi kryesore për arritjen efikase të qëllimeve të Bankës Popullore dhe rritja e përdorimit të bazave të detajuara me mikro të dhëna, si dhe të ashtuquajturave depo të të dhënave voluminoze (angl.: Big data)

Veprimtaria hulumtuese	në procesin e hulumtimit. Zhvillimi i mëtejshëm i mjeteve ekonometrike, si bazë për avancimin e mëtejshëm të hulumtimeve.
-------------------------------	---

Qëllimi strategjik 1- Përmirësimi i infrastrukturës për zhvillimin e politikës monetare

Zbatimi i politikës monetare përballet me një sërë sfidash, në kushtet e proceseve të përshpejtuara të globalizimit, digjitalizimit dhe inovacionit. Këto procese ndikojnë në strukturën e ekonomisë, sjelljen e subjekteve ekonomike dhe në vendimet e tyre, si dhe në mekanizmin e transmetimit të politikës monetare. Karakteristikat e ekonomisë maqedonase, e cila është duke kaluar në proces reformash strukturore, integrim të përforcuar tregtar dhe financiar, dhe në të njëkohësisht rëndësia në rritje e ndryshimeve klimatike, imponojnë nevojën për t'u fokusuar në analiza dhe hulumtime, përmes të cilave mund të vlerësohen efektet e ndryshimeve dhe të cilat ndihmojnë në zbatimin e politikave të duhura.

Pandemia e Kovid-19 gjithashtu mund të ndryshojë në terme afatgjatë sjelljen e subjekteve dhe të ngadalësojë ose përshpejtojë proceset e globalizimit dhe digjitalizimit. Hulumtimet në periudhën strategjike të ardhshme do t'i kushtohen këtyre ndryshimeve dhe pasojave të tyre në hartimin dhe përcaktimin e politikës monetare në ekonominë vendase.

Për arritjen e politikës monetare efektive janë të nevojshëm numër i madh hulumtimesh të cilat do të kontribuojnë në kuptimim më të mirë të transmetimit monetar, ekonomisë reale, lidhjeve makrofinanciare, marrëdhënieve ndërsektoriale financiare dhe fushave të tjera të cilat janë vendimtare në përcaktimin dhe zbatimin efektiv të politikës monetare.

Në një mjedis të tillë, Banka Popullore do të vazhdojë të jetë e përkushtuar në arritjen e qëllimit të saj kryesor – stabilitetin e çmimeve dhe kursit të këmbimit përmes **disa aktiviteteve**:

- ❖ Përmirësimi i procesit të parashikimit dhe modelimit, duke ruajtur dhe zgjeruar portofolin e modeleve të disponueshme të hartimit dhe simulimit të politikave;
- ❖ Veprimtaritë e aplikimit të modeleve të reja të ekuilibrit të përgjithshëm dinamik, duke përfshirë modelin e mosmarrveshjeve financiare;
- ❖ Zhvillimi i modeleve të parashikimit afatshkurtër, duke përfshirë lloje të reja të dhënash me frekuencë të lartë dhe qasje të reja, për modelimin më të mirë të ndryshimeve në sjelljen e subjekteve dhe marrëdhëniet në ekonomi të shkaktuar nga pandemia;
- ❖ Përshtatja e projeksioneve makroekonomike të nevojave për stres-testet e sistemit bankar, si mjet jashtëzakonisht i rëndësishëm në vlerësimin e efekteve të skenarëve të ndryshëm në bilancet e bankave;
- ❖ Shqyrtimi i mundësive për zbatimin e instrumenteve të reja monetare në pajtim me kushtet makroekonomike.

Rezultatet e pritura: Zhvillimi i kapaciteteve për perceptimin në kohë të rreziqeve, parashikimi i lëvizjeve dhe ndërlidhjeve të variablave individuale dhe si rrjedhim, hartimi në kohë dhe i përshtatshëm i politikës monetare dhe financiare dhe përcaktimi i masave. Përmirësimi i infrastrukturës analitike do të kontribuojë në përafrimin deri te praktikat më të mira të bankave qendrore.

Qëllimi strategjik 2 - Ruajtja dhe forcimi i mëtejshëm i stabilitetit dhe rezistencës të sistemit bankar

Ruajtja e stabilitetit financiar dhe ruajtja e besimit të publikut tek institucionet financiare kërkon marrjen e masave të duhura dhe në kohë. Në kuadër të mandatit të saj, Banka Popullore ndërmerr aktivitete për forcimin e vazhdueshëm të rezistencës së sistemit bankar dhe aftësisë për të amortizuar rreziqet. Në periudhën në vijim, sistemi financiar përballet me disa sfida të cilat dalin nga mjedisi i jashtëm: kriza shëndetësore, mbikëqyrja e ndryshimeve në rregullore dhe përshtatja me ndryshimet e imponuara nga inovacioni financiar, digjitalizimi dhe ndryshimet klimatike. Këto sfida do të forcojnë ekosistemin financiar, por në të njëjtën kohë do të ndryshojnë strukturën e tij. Banka Popullore, qëllimi i tërthortë i së cilës është rritja e qëndrueshme ekonomike, do të duhet të vlerësojë ndikimin e tyre kumulativ mbi stabilitetin financiar, transmetimin e politikës monetare dhe rritjen ekonomike.

Në kushtet të pasigurisë ende të lartë lidhur me kohëzgjatjen dhe intensitetin e krizës ekonomiko-shëndetësore, vëmendja e Bankës Popullore do të përqendrohet veçanërisht në mbikëqyrjen e lëvizjeve dhe vlerësimin e efekteve të krizës në sistemin bankar dhe më gjerë financiar. Rrjedhimisht, Banka Popullore do të rregullojë veprimin rregullator, në mënyrë që të ruajë dhe forcojë më tej stabilitetin dhe kapacitetin e sistemit bankar për të mbështetur ekonominë reale. Kështu, do të punohet në zbatimin e mëtejshëm të rekomandimeve të FSAP-it për forcimin e kapaciteteve të bankës qendrore për analizë dhe vlerësim më gjithëpërfshirës të rreziqeve për stabilitetin financiar.

Hap i rëndësishëm i forcimit të kornizës rregullative dhe institucionale gjatë vlerësimit dhe analizës së stabilitetit financiar është planifikimi i miratimit të Ligjit të Stabilitetit Financiar. Në bazë të këtij ligji dhe ndryshimeve të propozuara në Ligjin e Bankës Popullore të cilat do të miratohen gjatë periudhës në vijim, banka qendrore zyrtarisht do të kryejë mandatin e ri si rregullator makroprudencial dhe mbikëqyrës i bankave. Duke ndjekur standardet ndërkombëtare dhe legjislacionin europian, me qëllim të forcimit të rrjetit të sigurisë së sektorit financiar, Banka Popullore do të përfshihet në mënyrë aktive në finalizimin dhe zbatimin e Ligjit për Bankat dhe në përgatitjen e ndryshimeve në Ligjin për Fondin e Sigurimit të Depozitave.

Financimi digjital sjell modele të reja biznesi dhe ofrues më të ndryshëm të shërbimeve financiare, veçanërisht fintek dhe bigtek. Ndryshimet e tilla sjellin forma të reja rreziku, siç janë kërcënimet kibernetike. Rregullatorët dhe mbikëqyrësit duhet të vendosin ekuilibër midis katalizimit të inovacioneve dhe efikasitetit nën ndikimin e sektorit të fintekut dhe mirëmbajtjes së kuadrit rregullator të sigurt dhe të matur. Për shkak të promovimit të inovacioneve financiare dhe rritjes së ndërgjegjësimin për përfitimet dhe rreziqet e mundshme të digjitalizimit të shërbimeve financiare, Banka Popullore, në bashkëpunim me rregullatorët e tjerë financiarë dhe institucionet kompetente, do të përgatisë dhe miratojë strategjinë e parë të fintekut. Në këtë dokument do të vihet në dukje aktivitetet dhe masat kryesore të cilat duhet të zbatohen për të krijuar parakushtet e duhura për aplikim më të gjerë të shërbimeve fintek, rritjen e kapaciteteve të rregullatorëve për të kuptuar produktet dhe shërbimet e reja të cilat janë të bazuara në shërbimet fintek, por edhe për të kuptuar dhe menaxhuar siç duhet rreziqet të cilat rrjedhin nga zbatim i shërbimeve fintek në sistemin financiar.

Aktivitetet:

- ❖ Vendosja e mandatit makroprudencial të Bankës Popullore në lidhje me sistemin bankar, përgatitja e strategjisë makroprudenciale, brenda së cilës do të përcaktohet listë e treguesve të paralajmërimit të hershëm dhe do të përcaktohet listë e masave makroprudenciale të cilat mund të merren për ruajtjen dhe forcimin e stabilitetit të sistemit bankar;
- ❖ Përmirësimi i mëtejshëm i kornizës rregullator i cili do të sigurojë fuqizim shtesë të rrjetit të sigurisë së sektorit financiar;
- ❖ Forcimi i kapaciteteve të Bankës Popullore për të identifikuar dhe vlerësuar rreziqet sistematike;
- ❖ Integrimi i rreziqeve nga ndryshimet klimatike në vlerësimin e rrezikut për stabilitetin financiar;
- ❖ Përgatitja dhe miratimi i strategjisë fintek;
- ❖ Mbikëqyrja e efekteve nga kriza shëndetësore në sistemin bankar dhe më gjerë në stabilitetin financiar;
- ❖ Përmirësimi i mëtejshëm i kornizës së përgjithshme mbikëqyrëse (stres testimi, përmirësimi i modeleve ekzistuese dhe ndërtimi i modeleve të reja; zhvillimi i procedurave të koordinimit të funksionit mbikëqyrës dhe funksionit për zgjidhjen e bankave; monitorimi i rreziqeve të teknologjisë informatike dhe kibernetike);
- ❖ Krijimi i funksionit mbikëqyrës për institucionet e reja të pagesave

Rezultati i pritshëm: Sistemi financiar i forcuar, rezistent ndaj rreziqeve të mjedisit të jashtëm

Qëllimi strategjik 3 - Mbështetja e popullatës dhe sektorit të korporatave përmes zhvillimit të sistemeve pagesore të besueshme, inovative dhe efikase

Zhvillimi i teknologjive financiare dhe inovacioneve nënkupton ofrues të rinj shërbimesh, modele biznesi, produkte dhe zgjidhje, duke imponuar kështu strukturë të re, më moderne të ekosistemit financiar. Sistemet pahesore janë segment i këtyre ndryshimeve të rëndësishme. Teknologjia e sistemit pagesor është duke u zhvilluar me shpejtësi duke mundësuar më shumë forma pagesore elektronike dhe grup më të gjerë shërbimesh për klientët. Zhvillimi i teknologjive të informacionit ka rol të rëndësishëm në rritjen e konkurrencës dhe ripërcaktimin e marrëdhënieve midis konsumatorëve dhe ofruesve të shërbimeve pagesore, si dhe në përforcimin e efikasitetit.

Banka Popullore, si derimëtani, do të luajë rol kryesor në zhvillimin e mëtutjeshëm të tregut të shërbimeve pagesore, duke sjellë politika dhe kornizë të përshtatshme ligjore e cila është në hap me ndryshimet, si dhe do të mbështesë aktivitetet e popullatës dhe sektorit të korporatave. Për këtë qëllim, Banka Popullore do të punojë në kornizë e cila do të marrë parasysh ndryshimet në teknologjinë e sistemeve pagesore dhe ndikimin e tyre në funksionimin e subjekteve ekonomike.

Me legjislacionin e ri, i cili zhvendos dispozitat e Drejtorisë së Shërbimeve Pagesore dhe drejtorive të tjera përkatëse të Bashkimit Europian në fushën e pagesave zgjerohen detyrimet dhe kompetencat e Bankës Popullore në fushën e licencimit të operatorëve të sistemit pagesor,

institucioneve pagesore dhe emetuesve të parasë elektronike, si dhe në fushën e instrumenteve pagesore dhe llogarive të pagesave. Për këtë qëllim, në periudhën e ardhshme do të punohet në miratimin dhe zbatimin e akteve nënligjore, zhvillimin e mëtejshëm të mbikëqyrjes direkte dhe indirekte të sistemeve pagesore, si dhe vendosjen e funksionit mbikëqyrës mbi subjektet e tjera të infrastrukturës së tregjeve financiare duke zbatuar Parimet e Tregjeve të Infrastrukturës Financiare. Prandaj, në periudhën e ardhshme trevjeçare veçohen këto **aktivitete**:

- ❖ Mundësimi i hyrjes së ofruesve të rinj të shërbimeve pagesore dhe operatorëve të sistemit pagesor;
- ❖ Futja e instrumenteve të reja pagesore dhe zgjidhjeve më efikase për fillimin e pagesave në kushtet e konkurrencës më të madhe dhe transparencës më të lartë të tarifave;
- ❖ Transformimi digjital dhe ngritja e cilësisë së shërbimeve pagesore duke ngritur sistem për paraqitjen dhe publikimin krahasues të tarifave të ngarkuara nga ana e ofruesit të shërbimeve pagesore ndaj përdoruesit, për shërbimet më të përfaqësuara të cilat lidhen me llogaritë pagesore;
- ❖ Zbatimi i standardit ISO 20022 për mesazhet pagesore në MIPS-in, i cili do të imponojë nevojën e rregullimit të aplikacioneve të brendshme në të cilat përpunohen këto mesazhe;
- ❖ Zbatimi i Politikës së re për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit me qëllim të forcimit të procedurave operative dhe sistemeve të përdorura nga Banka Popullore në ofrimin e shërbimeve pagesore;
- ❖ Zhvillimi i kapaciteteve analitike nëpërmjet përdorimit të të dhënave të reja mbi statistikën e pagesave, mbikëqyrje të inovacioneve dhe harmonizimit të mëtejshëm me standardet e BQE-së dhe BIS-it në këtë fushë.

Rezultatet e pritshme:

- ❖ Shfaqja e institucioneve të reja në treg, si institucionet pagesore, institucionet e parasë elektronike dhe operatorët e rinj të sistemit pagesor;
- ❖ Rritja e konkurrencës, efikasiteti, transparenca, përfshirja më e madhe dhe mbrojtja më e mirë e përdoruesve të shërbimeve pagesore;
- ❖ Përdorimi më i madh i instrumenteve pa para të gatshme, efikase dhe të sigurtë për kryerjen e pagesave, gjë që reflekton pozitivisht në uljen e kostove të transaksioneve në ekonomi, si dhe në rritjen e shkallës së digjitalizimit të shoqërisë maqedonase.

Qëllimi strategjik 4 - Përmirësimi i politikës së investimeve dhe sigurimi i kthimit optimal të rezervave valutore në pajtim me parimet e sigurisë dhe likuiditetit

Lëvizjet në tregjet financiare ndërkombëtare, si dhe vlerësimet për rritjen dhe dinamikën e inflacionit në nivel global, tregojnë për ruajtjen e mëtejshme të kushteve aktuale në tregjet financiare. Pritet që edhe në periudhën e ardhshme të zbatohen norma të ulëta dhe negative të interesit të instrumenteve kryesore nga ana e BQE-së dhe bankave tjera qendrore kryesore. Mbizotërimi i kthimeve negative dhe të ulëta të instrumenteve financiare në tregjet ndërkombëtare janë faktorë të rëndësishëm të cilët ndikojnë në shumën e të ardhurave nga investimi në rezervat valutore. Faktor shtesë i cili do të ndikojë në zhvillimet në tregjet financiare ndërkombëtare është edhe pritja për tendencë të mëtejshme rritëse të kthimeve të tregut duke pasur parasysh perspektivat për rimëkëmbjen e ekonomive udhëheqëse, të cilat mund të ndikojnë në vlerësimin e instrumenteve financiare të vendosura brenda rezervave valutore. Në mjedis të

tillë, Banka Popullore në periudhën vijuese do të vazhdojë me forcimin e kapacitetit institucional për menaxhim të sigurtë të rezervave valutore, ruajtjen e likuiditetit të nevojshëm dhe sigurimin e kthimit optimal të mbajtjes dhe investimeve.

Aktivitete:

- ❖ Zgjedhje e instrumenteve të cilat mundësojnë ekspozim të balancuar ndaj rrezikut të interesit dhe kredisë, që të kufizohen efektet e pafavorshme të tregut të investimeve;
- ❖ Hulumtimi i mundësive për diversifikimin e rezervave devizore nga aspekti valutor dhe për rritjen graduale të investimeve në letra me vlerë, të klasifikuara si instrumente të mbajtura deri në maturim (të matura me koston e blerjes të amortizuar), të cilat sipas karakteristikave të tyre ofrojnë performancë financiare të parashikueshme dhe të qëndrueshme

Rezultatet e pritshme: Kufizimi i efekteve të pafavorshme të kthimeve negative në investimin e rezervave valutore dhe siguri i kthimit optimal pa cenuar sigurinë dhe likuiditetin e investimeve.

Qëllimi strategjik 5 - Përshtatja me standardet e Sistemit European të bankave qendrore

Orientimi i ekonomisë maqedonase drejt Bashkimit European imponon nevojën e angazhimit të të gjitha institucioneve, përfshirë edhe Bankën Popullore, në lloje të ndryshme aktiviteteve dhe projektsh reformuese që në afat të mesëm dhe afatgjatë përmirësojnë pajtueshmërinë e punës së institucioneve me rregulloren e Bashkimit European. Krahas zbatimit të llojeve të ndryshme të direktivave dhe standardeve europiane në punë, Banka Popullore do të vazhdojë të kontribuojë në zhvillimin dhe zbatimin e programeve të rregullta të reformave ekonomike dhe dokumenteve të tjera strategjike. Gjithashtu, aktivitetet për forcimin e kapaciteteve institucionale duke shqyrtuar përvojat e vendeve të tjera që kanë kaluar në rrugën e integritetit european janë të rëndësishme kryesore për gatishmërinë për fazat e ardhshme të procesit të integritetit european. Në këtë kontekst është edhe nevoja për të ruajtur dhe forcuar më tej pavarësinë e Bankës Popullore, në pajtueshmëri me pavarësinë e të cilën e kanë bankat qendrore të cilat janë anëtare të Sistemit European të Bankave Qendrore.

Aktivitete:

- ❖ Monitorimi dhe harmonizimi i vazhdueshëm i rregulloreve të Bankës Popullore me legjislacionin e Sistemit European të Bankave Qendrore;
- ❖ Rishikimi i përvojave të vendeve të tjera të cilat kanë kaluar në procesin e integritetit european;
- ❖ Forcimi i pavarësisë së bankës qendrore dhe forcimi i mekanizmave të kontrollit në menaxhim, nëpërmjet përshtatjes së kuadrit ligjor në pajtim me rekomandimet e FMN-së dhe BQE-së, si dhe për harmonizimin e mëtejshëm me praktikën më të mira europiane dhe botërore.

Rezultatet e pritshme: Harmonizimi me rregulloren e Bashkimit European në fushat që mbulohen nga kapitujt e ligjit të Bashkimit European (acquis communautaire), në të cilin merr pjesë Banka Popullore dhe fuqizimi i kapaciteteve institucionale dhe analitike për ballafaqim më të suksesshëm me sfidat gjatë fazave të ardhshme të procesit të integritetit european.

Qëllimi strategjik 6 - Rritja e transparencës dhe llogaridhënies

Qëllimi i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut është që të jetë institucion vazhdimisht i hapur dhe transparent, roli, funksioni dhe detyrat e të cilit i kupton publiku dhe të gjitha palët e interesuara. Për arritjen e këtij qëllimi, Banka Popullore vazhdimisht ndërmerr aktivitete me të cilat kërkon që të gjitha subjektet e interesuara të informohen me kohë për vendimet, aktivitetet, vëzhgimet dhe vlerësimet e saj, të cilat janë të rëndësishme për subjektet ekonomike dhe qytetarët, përfshirë edhe procesin e vendimmarrjes. Në kuadër të këtij qëllimi, Banka Popullore përpaket për shpërndarjen në kohë dhe më efikase të të dhënave të cilat i përgatit.

Me realizimin e vazhdueshëm të këtij qëllimi strategjik, Banka Popullore i kushton vëmendje ndërtimit dhe ruajtjes së besimit të qytetarëve dhe të gjithë subjekteve ekonomike, që është me rëndësi të jashtëzakonshme për mjedisin ekonomik. Përmes disponueshmërisë edhe më të madhe të informacionit për kategori të ndryshme subjektësh (qytetarë, kompani, gazetarë), komunikim i zgjeruar dhe bashkëpunim brenda dhe jashtë vendit, Banka Popullore do të vazhdojë të rrisë transparencën e saj. Në realizimin e misionit të saj për rritjen e disponueshmërisë, Banka Popullore ka bashkëpunim të ngushtë me rregullatorë të tjerë, institucione, organe dhe trupa të ndryshëm, si dhe është përkushtuar për të gjitha kërkesat e publikut të gjerë, si dhe për adresuar të gjitha pyetjet të cilat i drejton publiku, dhe që janë në kompetencën e tij. Për realizimin më të mirë të këtij angazhimi strategjik, gjatë tre viteve të ardhshme vëmendje e veçantë do t'i kushtohet forcimit të bashkëpunimit me të gjithë palët e interesit përkatëse brenda dhe jashtë vendit.

Aktivitete:

- ❖ Zhvillimi i strategjisë dhe përmirësimi i mëtejshëm i procedurave të komunikimit;
- ❖ Zbatimi i standardeve më të larta të transparencës dhe qartësisë në raportimin tonë ligjor në përmbushjen e detyrimeve tona të llogaridhënies (raportet financiare vjetore të Bankës Popullore, raporti i revizionit të pavarur dhe bilanci mujore, raportet vjetore të Bankës Popullore, të stabilitetit financiar dhe sistemit bankar etj.);
- ❖ Përmirësimi i disponueshmërisë së informacionit në faqen e internetit në pajtim me parimet e transparencës të parapara me Kodin e FMN-së për transparencën e bankave qendrore dhe për qasje më të lehtë në informacionin e cila është kompetencë e Bankës Popullore, rritja e vëllimit të informacionit me kategori të reja të përmbajtjes dhe ofrimi i më shumë hapësirës për forum të shkëmbimit të ideve dhe pikëpamjeve, ndër të tjera për të mbështetur dhe zhvilluar hulumtimin dhe analizën;
- ❖ Rritja e pranisë në rrjetet sociale nëpërmjet formave moderne të prezantimit dhe komunikimit dhe mbajtjes së vazhdueshme të komunikimit të drejtpërdrejtë me publikun, në pajtim me praktikën më të mira të bankës qendrore;
- ❖ Përmirësimi i disponueshmërisë së informacionit për mbrojtjen e konsumatorëve;
- ❖ Publikimi i rregullt i punimeve të punonjësve, organizimi dhe prezenca në ngjarje profesionale dhe shkencore, në mënyrë që Banka Popullore të përpaket në të ardhmen të kontribuojë për publikun shkencor dhe profesional, për të kontribuar në përhapjen e njohurive në shoqëri, si dhe afirmimi i institucionit jashtë vendit;
- ❖ Të dhëna lehtësisht të qasshme, cilësore dhe në kohë, të cilat janë në kompetencë të Bankës Popullore;
- ❖ Njohja e publikut me aktivitetet lidhur me punën e Muzeut të Bankës Popullore.

Rezultatet e pritshme:

- ❖ Njohje më e madhe e qëllimeve dhe detyrave të Bankës Popullore;
- ❖ Pajtueshmëri me kriteret e parashikuara të transparencës në pajtim me Kodin e Transparencës së Bankës Qendrore të FMN-së;
- ❖ Kontribut në procesin e vendimmarrjes dhe politikëbërësve në vend, si dhe kontribut ndaj publikut shkencor e profesional edhe në përhapjen e njohurive në shoqëri, si dhe në zhvillimin e përfshirjes së institucionit në aktivitetet dhe proceset me karakter ndërkombëtar, i cili do të kishte rëndësi të drejtpërdrejtë edhe për perceptimet e ekonominë maqedonase dhe subjekteve ekonomike.

Qëllimi strategjik 7 – Edukimi financiar dhe gjithëpërfshirja

Banka Popullore gjatë viteve të fundit ka rritur aktivitetet e saj të edukimit financiar, të synuara si për të rinjtë ashtu edhe popullatën në moshë të rritur. Popullata e arsimuar financiarisht ka më shumë njohuri për përfitimet e përdorimit të shërbimeve të ndryshme financiare, si dhe ndërgjegjësimin të lartë rreth rreziqeve. Kjo në përfundim siguron përfshirje më të madhe të popullsisë në rrjedhat financiare dhe qasje të lehtësuara **deri te financat**. Nevoja për edukim më të madh financiar është veçanërisht e theksuar në rrethanat e rritjes së shpejtë të sektorit të fintekut, i cili mundëson qasje më të lehtë deri te produktet financiare të reja, më konkurruese ose forma financimi për familjet dhe ndërmarrjet e vogla.

Me miratimin dhe zbatimin e Strategjisë të edukimit financiar dhe përfshirjes financiare do të sigurohej përfshirje më të madhe financiare në segmente të ndryshme të sistemit financiar, angazhim më i madh i institucioneve rregullatore në aspektin e edukimit dhe rregullores, por edhe për institucionet financiare private në drejtim të ofrimit më të madh të disponueshmërisë dhe informacionit rreth shërbimeve financiare të ofruara, duke përfshirë edhe rreziqet të cilat lidhen me to. Në të ardhmen, Banka Popullore do t'i kushtojë vëmendje **aktiviteteve** të mëposhtme:

- ❖ Fuqizimi i koordinimit dhe bashkëpunimit me institucionet rregullatore nga Trupi Koordinues i Edukimit Financiar dhe Përfshirjes lidhur me zbatimin e Strategjisë të Edukimit Financiar dhe Përfshirjes Financiare;
- ❖ Forcimi i bashkëpunimit me institucionet nga sektori financiar privat dhe shoqatat civile në lidhje me zbatimin e Strategjisë të edukimit financiar dhe përfshirjes financiare, me qëllim të ngritjes së nivelit të edukimit financiar të popullsisë dhe përfshirjes më të madhe financiare në vend;
- ❖ Miratimi dhe zbatimi i Kodit të Praktikave të Mira të Edukimit Financiar për të mundësuar promovimin dhe zbatimin e edukimit financiar cilësor, të paanshëm nga të gjitha subjektet e përfshira të cilat kryejnë veprimtari edukative për popullatën;
- ❖ Miratimi dhe zbatimi i kompetencave bazë për edukim financiar për të gjitha grupmoshat, duke filluar nga moshë parashkollore, për nxënësit e arsimit fillor dhe të mesëm, si dhe për popullatën në moshë të rritur;
- ❖ Përmirësimi i informimit të popullatës dhe veçanërisht forcimi i rolit të sektorit privat në fushën e informimit të klientëve;
- ❖ Ndërmarrja e aktiviteteve të duhura edukative për grupet e synuara individuale për përzgjedhjen e duhur dhe rreziqet në përdorimin e produkteve dhe shërbimeve financiare.

Rezultatet e pritshme: Rritja e ndërgjegjësimit dhe edukimit financiar të popullatës, informimi më i mirë i konsumatorëve të produkteve financiare për lloje të ndryshme të produkteve financiare, si dhe rreziqet e përdorimit të tyre dhe forcimi i aftësisë për të zgjedhur produktet e duhura financiare dhe menaxhimin e duhur të financave personale.

Qëllimi strategjik 8 – Rritja e ndërgjegjësimit për ndryshimet klimatike dhe kontributi për ekonomi të gjelbër e të qëndrueshme

Ndryshimet klimatike, si një nga kërcënimet më të mëdha globale, po fitojnë gjithnjë e më shumë rëndësi në veprimtarinë e bankave qendrore, si institucione me përgjegjësi shoqërore. Në këtë kontekst, mbrojtja e mjedisit dhe fokusi tek "rritja e gjelbër" dhe financimi i tij janë gjithnjë e më shumë pjesë e politikave të bankave qendrore. Prandaj, në tre vitet e ardhshme, çështjet e ndryshimeve klimatike dhe efektet e tyre në ekonomi do të jenë pjesë e portofolit hulumtues të Bankës Popullore, si dhe pjesë e udhëheqjes së politikës monetare. Gjithashtu, kjo nënkupton ndërmarrjen e aktiviteteve për monitorimin dhe menaxhimin e rreziqeve të ndryshimeve klimatike, si dhe analizën e ndikimit të rreziqeve të ndryshimeve klimatike në sistemin bankar. Banka Popullore, si institucion i cili është gjithmonë në ballë të proceseve në shoqëri, si dhe institucion i përgjegjshëm shoqëror, do të përpiqet të jetë shembull dhe të kontribuojë në krijimin e ekonomisë "së gjelbër" dhe të qëndrueshme, e cila në fund të fundit do të sigurojë përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve dhe përmirësimin e standardit të tyre të jetesës.

Aktivitete

- ❖ Promovimi i vetëdijes mjedisore dhe zvogëlimi i gjurmës ekologjike në funksionimin e Bankës Popullore, si dhe përmirësimi i kushteve të punës në objektin e ri i cili përfshin hapësirë pune dhe pajisjet me zgjidhje optimale nga aspekti ekologjik, shëndetësor dhe tekniko-teknologjik;
- ❖ Qasja proaktive dhe përdorimi i instrumenteve monetare të cilat nxisin dhe stimulojnë financat e gjelbra në ekonominë vendase;
- ❖ Analizë e mundësisë të formimit të portofolios të "detyrimeve të gjelbra" brenda portofolit të rezervave valutore;
- ❖ Hulumtimi mbi ndryshimet klimatike dhe efektet e tij në sistemin bankar dhe ekonominë në përgjithësi;
- ❖ Rritja e ndërgjegjësimit për rreziqet e ndryshimeve klimatike dhe marrja e aktiviteteve dhe masave konkrete për menaxhimin dhe kufizimin e tyre;
- ❖ Aktivitete me përgjegjësi shoqërore dhe kontribut në krijimin e ekonomisë "të gjelbër" dhe të qëndrueshme.

Rezultatet e pritshme: Krijimi i mjedisit ekologjikisht të pastër dhe të shëndetshëm, kushte më të mira jetese për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm.

Qëllimi strategjik 9 - Forcimi i menaxhimit të riskut në nivel të Bankës Popullore

Bankat qendrore përballen me sërë rreziqesh të qenësishme financiare dhe operacionale, të cilat mund të kenë efekt rreth rezultatit financiar, por edhe rreth reputacionit. Prirja e digjitalizimit dhe ndryshimeve teknologjike në operacione është përforcuar ndjeshëm që nga fillimi i krizës globale shëndetësore, nëpërmjet futjes së funksionimit në distancë dhe kryerjes së proceseve të punës në shtëpi. Kjo kontribuon në rritjen e prirjeve të kërcënimeve kibernetike, gjë që imponon nevojën për mbikëqyrje të shpeshtë dhe identifikimin në kohë të rreziqeve të reja, forcimin e masave për sigurimin e sistemit të informacionit, përfshirë rezistencën kibernetike, si dhe funksionimin e pandërprerë. Pajtueshmëria me rregulloret ligjore dhe normat etike është jashtëzakonisht e rëndësishme për të ulur rrezikun ligjor dhe reputacionin në nivelin më të ulët. Prandaj, theks i veçantë i kushtohet forcimit të ndërgjegjësimit për pajtueshmërinë në punë dhe veprime, dhe në këtë mënyrë forcimin e mëtejshëm të integritetit të bankës qendrore.

Aktivitetet:

- ❖ Organizimi i një kornizë të integruar për menaxhimin e rrezikut dhe forcimi i mekanizmave të menaxhimit për kontrollin e brendshëm të rrezikut;
- ❖ Menaxhimi efektiv me risitë në të gjitha segmentet e funksionimit të realizimit të qëllimeve të strategjive;
- ❖ Përmirësimi i procesit të planifikimit, analizimi i pozitës financiare dhe realizimit të ishte i suksesit dhe i planit financiar;
- ❖ Përforsimi i pozicionit të kapitalit të bankës për mbrojtje nga rritja e rreziqeve në funksionimin e Bankës Popullore dhe përkufizimi i dinamikës së mekanikës në shpërndarjen e fitimeve përmes së cilit do të ndërtohen rezervat e përgjithshme të Bankës Popullore;
- ❖ Përorcimi i mëtejshëm i sigurisë së sistemit të informacionit dhe siguri i vazhdimësisë në operim nëpërmjet mbikëqyrjes së intensifikuar ndaj kërcënimeve kibernetike, forcimit të masave kibernetike dhe qëndrueshmërisë operacionale, si dhe ndërgjegjësimi i punonjësve rreth rolit të tyre në garantimin e sigurisë së sistemit të informacionit, mbrojtjen e të dhënave personale dhe sigurinë e informacionit të klasifikuar;
- ❖ Përmirësimi dhe forcimi i pajtueshmërisë në nivel të bankës, promovimi aktiv dhe i duhur i saj, monitorimi i vazhdueshëm i rregulloreve aktuale dhe informimi i menaxhmentit;
- ❖ Rritja e kapaciteteve institucionale për menaxhimin e rrezikut juridik dhe zgjidhjen e çështjeve pronësore;
- ❖ Përmirësimi i mëtejshëm i masave të sigurisë në objektet ekzistuese dhe instalimi i sistemeve të reja më të avancuara për mbështetjen e sigurisë dhe kushteve për sigurinë dhe shëndetin në punë, për mbarëvajtjen e proceseve të punës në objektin e ri.

Rezultatet e pritshme: Menaxhimi efektiv i rrezikut në të gjitha segmentet e operimit me qëllim të arritjes së qëllimeve strategjike, përforsimit të masave dhe zvogëlimit të rreziqeve të mbetura, përmirësimit të rezistencës dhe sigurisë së Bankës Popullore.

VI. Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

3. Ky plan hyn në fuqi në ditën e miratimit të tij, ndërsa do të zbatohet nga 1 janari 2022.
4. Me fillimin e zbatimit të këtij plani, Plani Strategjik i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut për periudhën 2020-2022 PS-ja nr. 02-15 / VI-1/2019 nga data 30 maj 2019 pushon së vlejture.

PS-ja nr. // // // // // 4 qershor 2021, Shkup	Guvernatore dhe Kryesuese e Këshillit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut d.r. Anita Angellovska-Bezhoska
---	--



BANKA POPULLORE
E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT